

Fjala e guvernatorit

Fillimi dhe mbarimi i tremujorit të dytë të vitit 1999 përkoi me fillimin dhe mbarimin e konfliktit të armatosur në Kosovë. Në këtë periudhë vëmendja u përqendrua në çështjet politike e ushtarake, në administrimin e një shpërnglujeje masive me dhunë të një populli të tërë drejt vendeve fqinje, kryesisht drejt Republikës së Shqipërisë, dhe kthimin në vatrat e tyre. Në tërësi kjo periudhë u karakterizua nga dy elemente kryesore: paqartësia në zhvillimin e ngjarjeve dhe parashikimin e tyre si dhe angazhimi total i komunitetit ndërkombëtar për të zgjidhur jo vetëm konfliktin në Kosovë dhe ndihmuar popullin e saj, por edhe për të mbështetur vendet përreth në kapërcimin e kësaj krize.

Nuk mund të mohohet fakti që Shqipëria mbajti peshën kryesore duke pritur rreth gjysmë milioni banorë, ndërkohë që kishte mungesa të theksuara në infrastrukturë gjë që e vështirësoi detyrën e saj. Siç e kam theksuar tashmë, situata ekstreme u arrit të administrohej si pasojë e reagimit të menjëhershëm dhe mbështetjes së gjithanshme që u ofrua për Shqipërinë nga komuniteti ndërkombëtar dhe nga angazhimi total i qeverisë dhe i vetë popullit shqiptar.

Duhet kuptuar se kur je pranë luftës dhe përfshihesh në konflikte të armatosura, qoftë edhe sporadike, siç ndodhi me Shqipërinë, pak vend i mbetet ekonomisë. Gjithë vëmendja dhe energjitë përqendrohen në përballimin e konfliktit. Megjithatë, me kënaqësi vërej që **situata ekonomike për tremujorin e dytë nuk u përkeqësua ashtu siç ishte parashikuar**. Pasojat negative të konfliktit u zëvendësuan deri diku me të tjera ngjarje, të cilat bënë që në tërësi ekuilibrat të ruhen.

Objektivat e vendosur për rritjen ekonomike dhe inflacionin për vitin 1999 nuk u ndryshuan, ndërsa buxheti i shtetit siguroi një mbështetje të konsiderueshme prej 10 milionë dollarë amerikanë për të mbuluar mosarkëtimin e të ardhurave si dhe rreth 150 milionë dollarë amerikanë për të përballuar koston e konfliktit.

Në përgjithësi, për tremujorin e dytë të vitit 1999, zhvillimet monetare kanë qenë pozitive; janë rritur rezervat valutore të autoritetit monetar; monedha kombëtare gjatë periudhës pesëmuajore (prill-gusht 1999) ka qenë vazhdimisht e vlerësuar në raport me monedhat e huaja; norma mujore e inflacionit ka shënuar nivele negative; është gjallëruar sektori i shërbimeve dhe madje të ardhurat nga eksporti i shërbimeve janë rritur rreth 4.6 herë më shumë se periudha paraardhëse; aktiviteti tregtar me pjesën tjetër të botës jo vetëm nuk u tkurr, por, ndryshe nga sa ishte parashikuar, eksportet u rritën me 7 për qind kundrejt tremujorit paraardhës; bilanci i transaksioneve korente ka shënuar një suficit prej 30 milionë dollarë amerikanë, ndërsa zhvillimet në llogarinë financiare kanë qenë të balancuara.

Vlerësohet se situata makroekonomike në Shqipëri do të jetë në kufijtë e programuar. Mbi të gjitha, objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë, do të realizohet, madje vlerësohet që në fund të vitit norma vjetore e inflacionit do të jetë jo më shumë se 5 për qind. Në arritjen e këtij objektivi kanë kontribuar, veç të tjerave, realizimi i objektivave sasiorë monetare si dhe mbajtja nën kontroll e zhvillimeve fiskale. Banka e Shqipërisë beson se edhe për të ardhmen qeveria do të jetë tërësisht e angazhuar për të respektuar kufijtë e vendosur për deficitin buxhetor, sidomos atë të financuar me burime të brendshme.

Nga konflikti i Kosovës Shqipëria fitoi shumë moralisht dhe në planin historik.

Renditja në një krah me fuqitë më të mëdha ushtarake e politike të botës, mbështetja për operacionet e NATO-s dhe prania e këtij organizmi në Shqipëri, gatishmëria për të pritur të shpërngulurit me dhunë që arritën deri në 15 për qind të popullsisë së vendit, interesi i treguar nga udhëheqës shtetesh dhe organizma shumëkombësh, janë një sërë faktorësh të cilët krijojnë një bazë mbështetjeje për zhvillim të vendit në të ardhmen. Ajo çfarë kërkohet nga shqiptarët është të dinë të shfrytëzojnë këtë kapital moral të fituar dhe të mos lejojnë të na ikin nga duart shanset që ka ofruar momenti historik. Kjo kapërcen kufijtë e angazhimit qeveritar dhe kërkon një reagim me pjekuri të të gjitha forcave politike e qytetarëve shqiptarë.

Shkëlqim Cani
Guvernator

Opinion mbi gjendjen e ekonomisë shqiptare në tremujorin e dytë të vitit 1999.

I. Konsiderata të përgjithshme.

Tremujori i dytë i vitit 1999 u karakterizua nga një paqartësi lidhur me parashikimin e ngjarjeve që do të ndodhnin dhe me një precipitim të menjëhershëm të tyre. Konflikti, që filloi në javën e fundit të muajit mars, u shoqërua me një dëbim masiv të popullsisë shqiptare të Kosovës, e cila u drejtua kryesisht për në Shqipëri. Brenda një periudhe prej dy javësh popullsia e Republikës së Shqipërisë u shtua me 15 për qind. Nga ana tjetër, mungesa e infrastrukturës përkatëse dhe e stabilitetit në vend në vitet e fundit e vështirësonin më tej detyrën e përballimit të kësaj shtate, e cila në mjaft raste arriti edhe në ballafaqimin me konflikt të armatosur me trupat ushtarake të ish-Jugosllavisë.

Megjithatë, administrimi i situatës u realizua mjaft mirë si pasojë e ndihmës e mbështetjes që u ofrua menjëherë nga komuniteti ndërkombëtar, angazhimit të qeverisë dhe vetë popullit shqiptar. Jo vetëm kaq, por përgatitjet u arritën të kryheshin për të pritur edhe një numër më të madh të shpërngulurish dhe për t'i mbajtur ata për një kohë relativisht të gjatë që kapërcente kufirin e vitit 1999.

Edhe pse besoj se konflikti do të vazhdonte deri në fund të vitit 1999, se popullsia e shpërngulur do të qëndronte në Shqipëri të paktën deri në gjysmën e parë të vitit 2000, përsëri ngjarjet morën kthesë të papritur. Nënshkrimi i marrëveshjes së paqes u pasua me një kthim të menjëhershëm të të gjithë të ardhurve nga Kosova për në trojet e tyre. Këto kthesa të papritura përmbysën dhe hamendjet, parashikimet dhe pritshmëritë e bëra më parë.

Duke ju kthyer edhe njëherë konfliktit, do të veçojmë fushat ku u mendua se do të ndikonte ky konflikt dhe ç'ndodhi në realitet.

- Një nga vështirësitë më të mëdha në momentet e fillimit ishte mungesa e një infrastrukture të përshtatshme sociale dhe ekonomike për të pritur qindra mijëra njerëz të shpërngulur me forcë nga trojet e tyre. Ky moment, përveç konfuzionit që krijoi, shkaktoi dhe një kosto për Shqipërinë në momentin fillestar.
- Vënia në dispozicion të trupave të huaja ushtarake dhe organizmave të tjera ndërkombëtare të një pjese të infrastrukturës ekzistuese në Shqipëri, si porti i Durrësit, aeroporti i Rinasit, apo furnizimi me energji elektrike i kampeve, bëri që ekonomisë shqiptare t'i mungonin të ardhurat që normalisht janë siguruar nga aktiviteti i këtyre objekteve.
- Në aspektin rajonal, konflikti shkaktoi një ndërprerje të marrëdhënieve tregtare ndërmjet ish-Jugosllavisë dhe shteteve të tjera ballkanike. Në rastin e Shqipërisë kjo nuk përbënte problem sepse prej vitesh

marrëdhëniet tregtare me këtë vend ishin tejet të kufizuara për të mos thënë inekzistente.

- Kriza, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndikoi në besimin e investitorëve të huaj të interesuar për vendet e rajonit si dhe në sektorin e turizmit. Edhe në këtë rast, humbjet që pati Shqipëria nuk ishin të konsiderueshme. Edhe pa këtë konflikt Shqipërisë i kishin munguar si investimet ashtu dhe turistët. Megjithatë, ekzistenca e trupave ushtarake, gazetarëve, punonjësve të organizatave ndërkombëtare etj., i dhanë impuls sektorit të shërbimeve.
- Nga tërësia e rrjedhojave që njohu realiteti ekonomik e politik i rajonit, pasoja më e dukshme negative është ajo që ka të bëjë me shtyrjen ose ngrirjen e reformave strukturore dhe procesit të privatizimit. Shqipëria, në këtë mënyrë, ka pësuar një humbje afatmesme pasi pasojat e kësaj ngrirjeje do të ndikojnë në të ardhmen në arritjen e objektivave për zhvillimin e vendit.
- Ndërkohë, Shqipëria besohet se ka fituar në planin moral e historik. Së pari, kjo ngjarje e dhimbshme ndikoi në përmirësimin e imazhit të vendit tonë të tronditur mjaft nga ngjarjet e vitit 1997. U shtua interesimi i organizmave të ndryshme rajonale e ndërkombëtare apo i shteteve të tilla si SHBA, Britania e Madhe etj., dhe u shpreh hapur mbështetja për zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë.

Konflikti në Kosovë pati ndikime shumë komplekse, të cilat u administruan me sukses dhe aktualisht ekonomia kombëtare gjykohet të jetë përmirësuar në krahasim me periudhën para shpërthimit të krizës.

Gjatë gjithë kësaj periudhe janë vërejtur edhe disa zhvillime pozitive në treguesit e ekonomisë reale. Bilanci i pagesave ka përmirësuar pozicionin e tij si nën ndikimin e burimeve tradicionale ashtu dhe ato të momentit. Infrastruktura shqiptare njohu përmirësime, që, gjithashtu, janë të dukshme. Kjo ka bërë që objektivi për rritjen ekonomike të vendit të mbetet i pandryshuar; ndërsa sjellja e çmimeve të konsumit gjatë tremujorit të konfliktit, por edhe në muajt vijues konfirmon se objektivi i vendosur tashmë është arritur. Madje vlerësohet që në fund të vitit norma e inflacionit do të jetë nën nivelin e programuar me të paktën 2 pikë.

Nga ana tjetër, vlerësohet se vendi njohu një periudhë ringjalljeje ekonomike sidomos në sektorët e shërbimit. Por, qëndrueshmëria afatgjatë e kësaj ringjalljeje vazhdon të vihet në dyshim nga vonesa e reformave strukturore.

Fundi i konfliktit në Kosovë, i dha jetë intensifikimit të përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për fuqizimin e proceseve integruese të vendeve ballkanike në nivel rajonal, por dhe një lidhjeje më të fuqishme të rajonit me Bashkimin European. Bazat e këtij bashkëpunimi, të cilat u hodhën në Samitin e Sarajevës, me pjesëmarrjen e kryetarëve të shteteve të rajonit dhe të vendeve të industrializuara të botës, paraqesin trasenë në të cilën do të kalojë ky

proces, i cili, megjithëse afatgjatë, e vendos integrimin Ballkanik në baza të qëndrueshme.

Zbatimi i këtij Pakti, në tërë komponentët e tij, do të plotësojë kuadrin tërësor, qoftë për forcimin e demokracisë e të sigurisë në rajon qoftë për të siguruar një rritje të qëndrueshme ekonomike rajonale brenda një bote më të globalizuar dhe më konkurruese. Ky Pakt krijon baza për një qëndrueshmëri politike dhe të sigurisë në rajon, të cilat janë parakushte të nevojshme për zhvillimin dhe nxitjen e sipërmarrjes së lirë private, si motorrët kryesorë të rritjes ekonomike.

Në këtë kuadër Shqipëria ka mundësi të përfitojë së tepërmi. Pranimi i Paktit dhe përpjekjet për vënien në jetë të tij ndihmojnë për një ringjallje të gjithanshme ekonomike, ngritje të infrastrukturës, apo sheshim të problemeve që kanë të bëjnë me ato fenomene, që janë theksuar tashmë shpeshherë si pengesa kryesore për zhvillim të vendit siç janë mungesa e rendit, korrupsioni, mungesa e transparencës së plotë mbi shpenzimet dhe ndihmën e huaj etj.

Respekti që fitoi Shqipëria gjatë periudhës së konfliktit, për mënyrën se si ajo trajtoi këtë krizë, i jep mundësi që ta shndërrojë këtë precedent të paparë në një avantazh ekonomik e politik për të ardhmen. Problemi që shtrohet tashmë është nëse do të jemi të aftë t'i shfrytëzojmë këto avantazhe dhe të mos vonohemi përsëri. Përgjigja e kësaj pyetjeje është e vështirë, pasi këtu ndërthuren shumë faktorë politikë, ekonomikë, socialë, kulturorë etj. Por, është e tepërt të thuhet që këtu duhet të përqendrohen të gjitha aftësitë dhe përpjekjet e autoriteteve shqiptare si dhe të vetë popullit shqiptar.

II. Mjedisi global.

Vlerësohet se ecuria e ekonomisë botërore, për pjesën e mbetur të vitit, do të ndikohet kryesisht nga suksesi i ekonomisë amerikane, zhvillimet në ekonominë e zonës së Euro-s si dhe rimëkëmbja e ekonomisë japoneze,.

Ecuria aktuale e **ekonomisë amerikane** po karakterizohet nga ritme të larta rritjeje. Me një rritje në masën 4 për qind, vlerësohet se niveli i papunësisë do bjerë nën 4 për qind deri në fund të vitit, nivel ky që pritet të çojë në përshpejtimin e inflacionit. Kjo rritje gjykohet të ketë si burim kryesor rritjen e produktivitetit dhe pjesërisht rritjen e punësimit. Megjithatë, problem vazhdon të mbetet inflacioni, i cili për tremujorin e dytë llogaritet të arrijë 4 - 5 për qind në nivel vjetor, nga 6.7 për qind që shënoi gjatë tremujorit të parë. Kjo pritshmëri ka detyruar Fed-in të jetë më i kujdesshëm dhe ka mundësi që rritja prej 0.25 pikë përqindjeje të pasohet nga të tjera në të ardhmen.

Sipas të dhënave paraprake të botuara nga Eurostat (gusht 1999), në **zonën e Euro-s**, PPB reale gjatë tremujorit të parë të vitit u rrit me 0.5 për qind më shumë se tremujori i kaluar (1.8 për qind në nivel vjetor). Stabilizimi në tërësi i rritjes së prodhimit ishte kryesisht kontributi i sektorit industrial. Treguesi i besimit të sektorit industrial, pas një rënijeje të lartë, të shënuar në muajin mars, ka filluar të rikuperohet. Për rrjedhojë, punësimi total i zonës vlerësohet të jetë rritur me 1.6 për qind gjatë tremujorit të parë të vitit 1999 kundrejt të

njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Në fund të muajit maj, niveli total i papunësisë kap shifrën 10.3 për qind, kundrejt 10.5 për qind që ishte në fillim të vitit. Në fund të muajit qershor, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit shënoi 0.9 për qind, në nivel vjetor. Zhvillimet në afat të shkurtër lidhur me inflacionin parashikojnë një rritje të moderuar, e influencuar nga rritja e çmimeve të mallrave energjitike dhe joenergjitike, efektet negative të cilave pritet të kundërbalancohen pjesërisht nga presionet që do të ushtrojë forcimi i konkurrencës në uljen e çmimeve në sektorin e shërbimeve, si rrjedhojë e derregullimeve dhe liberalizimeve që po shënohen në këtë sektor.

Sjellja e euro-s edhe gjatë tremujorit të dytë në tregjet monetare vazhdoi të luhatet kundrejt monedhave kryesore ndërkombëtare, pasuar në muajt korrik dhe gusht nga forcimi i saj kundrejt dollarit amerikan dhe sterlinës angleze.

Luhatjet kundrejt dollarit amerikan gjatë muajit qershor reflektuan paqëndrueshmërinë e tregjeve europiane rreth perspektivave të politikës monetare të Fed-it (të finalizuara me një rritje të normës së interesit prej 25 pikësh në 30 qershor) si dhe divergimin e treguesve të rritjes së ekonomisë së dy rajoneve. Niveli mesatar i kuotimit të euro kundrejt dollarit në muajn qershor shënoi 1.04 duke u ngjitur në kuotën e 1.07 në fund të muajit korrik. Ndërsa kundrejt jenit japonez, euro u luhat brenda "një korridori" më të ngushtë. Publikimi i të dhënave rreth rritjes ekonomike të Japonisë për tremujorin e parë, rezultoi në një vlerësim të jenit. Si rrjedhojë e ndërhyrjes së Bankës Qendrore të Japonisë, norma e këmbimit nuk shfaqti ndonjë tendencë të qartë. Ulja e normës së interesit nga Banka e Anglisë, kontribuoi në një vlerësim të lehtë të euro kundrejt sterlinës, duke u pasuar nga një zhvlerësim në vazhdim, në linjë me dobësimin e euro-s kundrejt dollarit.

Si rezultat i paketës stimuluese qeveritare, PPB reale e **Japonisë** në tremujorin e parë u rrit me 7.9 për qind, në nivel vjetor (ndërkohë që shpenzimet qeveritare u rritën me 48 për qind. Të dhënat paraprake për tremujorin e dytë flasin për një rritje jo në të njëjtat nivele si të periudhës së mëparshme. Megjithatë, vlerësohet se shërimi i ekonomisë po vazhdon, i stimuluar kryesisht nga rritja e shpenzimeve publike, gjë që manifestohet edhe në rritjen e besimit të investitorëve (Nikkei-225 gjatë këtij viti është rritur me 27 për qind mbi nivelin e vitit të kaluar).

Ndërsa perspektivat e rritjes për Triad-ën duken optimiste, skena e pjesës tjetër të botës mbetet mikse:

- Ekonomia e Brazilit po rimëkëmbet pas zhvlerësimit të monedhës së saj, ndërsa Argjentina, megjithëse mban të lidhur monedhën e saj me dollarin, është përfshirë nga frika e zhvlerësimit.
- Si rrjedhojë e rritjes së çmimit të naftës dhe mallrave primare, ekonomia e Kanadasë po shënon rritje.
- Rusia akoma ndodhet në fazë amullie, në pritje të marrjes së huasë së re, tashmë të aprovuar nga FMN, prej 4.2 miliardë dollarë.

- Kina shënoi një rritje vjetore të PPB prej 7.2 për qind në tremujorin e dytë, por me shenja të rënies së ritmeve (e përfshirë edhe nga mundësia e një zhvlerësimi të monedhës);
- Meksika parashikon një rritje vjetore të PPB prej 3 për qind.

III. Konflikti i Ballkanit dhe ekonomia e këtij rajoni.

Në tremujorin e dytë të vitit 1999 ekonomitë e vendeve të Ballkanit u bënë "peng" i konfliktit që shpërtheu në pranverën e këtij viti. Shumica e vendeve u detyruan të rishikojnë objektivat e tyre për investimet e huaja, rritjen ekonomike dhe reformat strukturore. Ato, në tërësi, u drejtuan kah komuniteti ndërkombëtar për të gjetur mbështetje për mbulimin e kostos së luftës të shkaktuar si nga shtyrja e investimeve dhe reformave ashtu edhe nga mbajtja e popullsisë së shpërngulur nga Kosova.

Në tërësi konflikti në këto vende veprroi në këto drejtime:

- Këtyre ekonomive, ku më shumë e ku më pak, iu shkaktua një kosto shtesë si pasojë e pritjes së popullsisë së shpërngulur nga Kosova.
- U ndërpreu lidhjet tradicionale të tregtisë e transportit. Pjesa më e madhe e këtyre vendeve kanë Serbinë si treg kryesor për produktet e tyre dhe si rrugë kryesore kalimi të këtyre produkteve për në tregjet e tjera.
- U pezulluan reformat strukturore dhe privatizimi i pronës publike.
- U reduktua niveli i investimeve të huaja në vend si pasojë e humbjes së besimit të investitorëve të huaj për rajonin.
- Sektori i turizmit, gjithashtu, pësoi një goditje.

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ishte shteti i dytë pas Shqipërisë që përballoi një fluks të madh popullsie të shpërngulur. Është vlerësuar që humbjet nga sektori i turizmit të arrijnë në 44¹ milionë dollarë në vit. Po kështu, dëm të konsiderueshëm pritet të pësojë bilanci i pagesave duke patur parasysh që 65 për qind e eksporteve (qoftë për konsum qoftë për tranzit) destinoheshin për në Serbi.

Bullgaria, Rumania, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, gjithashtu, do të dëmtohen nga ndërprerja e lidhjeve tregtare e të transportit. Objektivi për rritjen e ekonomisë bullgare u reduktua nga 3.7 në 2 për qind² si dhe u përgjysmua objektivi për investimet e huaja direkte. Ndërsa Kroacia parashikon humbje edhe në sektorin bankar si pasojë e investimeve të këtij të fundit në fushën e turizmit.

Sipas ministrit të financave³, kostoja e konfliktit për ekonominë e Greqisë pritet të arrijë në 0.2 për qind të PPB-së. Kështu, rritja e parashikuar prej 3.5 për

¹ Gazeta "New Europe", 14-20 qershor 1999.

² Gazeta "New Europe", 14-20 qershor 1999.

³ Gazeta "New Europe", 14-20 qershor 1999.

qind këtë vit do të reduktohet me 0.2-0.5 për qind. Greqia, duke qenë se ka një shtrirje të investimeve në tërë rajonin e Ballkanit pritet, gjithashtu, të pësojë dëmtime si nga shkatërrimi apo dëmtimi i investimeve të bëra në Serbi ashtu edhe nga investimet në rajonin e Ballkanit.

IV. Ekonomia Kombëtare.

Duke ju referuar të dhënave të botuara nga INSTAT, vërehet se **aktiviteti industrial**⁴, gjatë tremujorit të dytë, vazhdon të ruajë thuajse të njëjtat ritme si dhe në tremujorin paraardhës, me një rritje të lehtë prej 4,9 për qind. Megjithatë, shpërndarja mujore flet për tendenca të rënies të filluara gjatë muajit maj dhe qershor, pas pikut të rritjes që shënoi muaji prill. Edhe prodhimi mall i shitur⁵ i realizuar deri në fund të muajit korrik i krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar shënon një rënie prej rreth 9 për qind.

Nga një analizë e shkurtër e sektorëve industrialë vërehet se dobësitë më të mëdha mbeten në sektorin minerar, veçanërisht në industrinë e bakrit dhe kromit, ku nuk po arrihet as gjysma e aktivitetit ekonomik të realizuar nga ky sektor gjatë vitit të kaluar. Me përjashtim të sektorit të energjisë elektrike, e cila vazhdon të ruajë dinamizmin e prodhimit, në nivele të dobëta vazhdojnë të qëndrojnë edhe prodhimi i çimentos, materialeve të tjera të ndërtimit, industria metalurgjike etj. duket se procesi i privatizimit dhe ristrukturimit të disa prej këtyre sektorëve (siç është rasti i Kombinatit Metalurgjik) akoma nuk kanë filluar të japin efektet e tyre. Duke gjykuar nga treguesi i konsumit të çimentos, vërehet se sektori i ndërtimit vazhdon të ruajë dinamikën e rritjes, me një ritëm prej gati 16 për qind. Kjo, mund të besohet së, është rrjedhojë kryesisht e gjallërimit të projekteve publike të financuara nga Komuniteti Ndërkombëtar dhe nga NATO.

Duke gjykuar nga të dhënat e eksporteve, vërehet se aktiviteti ekonomik i firmave të huaja në sektorët e industrive tekstile, lëkurë-këpucëve dhe drurit ka vazhduar të ruajë ritmet normale. Megjithë një rënie të peshës specifike të kontributit të ri-eksporteve ndaj totalit të eksporteve në masën 5 për qind, kjo rënie u kundërbalancoi nga rritja më e lartë e eksporteve me orgjinë produktet e vendit. Në tërësi, kundrejt tremujorit të parë, eksportet u rritën me rreth 7 për qind, ndërkohë që importet e tregtueshme shënuan një rritje rekord prej rreth 39 për qind.

Kërkesa e brendshme, e gjykuar nga konsumi i disa mallrave të rëndësishme (energji elektrike, karburante, autovetura, pajisje shtëpiake dhe vetë rritja në tërësi e importeve), ka pësuar rritjen më të lartë të shënuar gjatë dy viteve të fundit, rrjedhojë kjo kryesisht e rritjes së dimensioneve të tregut të brendshëm.

⁴ Të dhënat i referohen indekseve mujore të volumit të Prodhimit të Përgjithshëm Industrial botuar nga INSTAT.

⁵ Sipas raportimeve operative të drejtorisë së Programim – Zhvillimit të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Mbi këtë bazë, kërkesa e brendshme besohet se do të jetë shtytja kryesore në rritjen ekonomike të vendit për pjesën e mbetur të vitit. Përbërja strukturore e prodhimit kombëtar, e bazuar kryesisht tek prodhimi bujqësor, një sektor më i imunizuar qoftë nga tronditjet e brendshme dhe ato të jashtme, tek sektori i shërbimeve, transportit dhe ndërtimit, na lejon të besojmë me optimizëm se **rritja ekonomike vjetore e parashikuar prej 8 për qind të jetë plotësisht e arritshme.**

Ndërkohë, të dhënat zyrtare të nivelit të papunësisë flasin për një rritje tjetër të saj. Në fund të tremujorit të dytë përqindja e papunësisë⁶ shënoi 18 për qind, krahasuar me 17,5 për qind në fund të tremujorit të mëparshëm. Është e pamundur të gjykosh mbi saktësinë⁷ e kësaj shifre, por të gjithë analistët, duke përfshirë edhe ata të huaj, gjykojnë se tremujori në fjalë krijoi hapësira të reja punësimi (ndoshta edhe të përkohshme). Këto hapësira të reja ndikuan në rritjen e të ardhurave, të cilat u siguruan kryesisht në formën e pagave dhe të ardhurave nga qiratë.

Vetë angazhimet e NATO-s në rehabilitimin e infrastrukturës shqiptare, operimi i dhjetra organizatave ndërkombëtare humanitare dhe mediave të huaja, krijuan shume vende të reja pune⁸ për shoferë, përkthyes, puntorë ndërtim-shkarkimi etj., paga e të cilëve kalonte disa herë pagën mesatare të vendit. Madje, rritje kanë pësuar edhe të ardhurat në sektorin publik (10 për qind në terma nominalë) si pasojë e shfuqizimit të vendimit të marrë në tremujorin e parë të vitit 1999 mbi bllokimin e shpenzimeve për administratën publike dhe investimet.

Megjithatë, aktualisht, analistët gjykojnë se prirja më e madhe drejt konsumit, si pasojë e sigurimit të të ardhurave të paparashikuara dhe vlerësimit të monedhës kombëtare, po zvogëlon gjithnjë më shumë atë pjesë të të ardhurave që duhet të investohej për të ardhmen.

VI. Zhvillimet ne inflacion.

Zhvillimet në çmimet e konsumit gjatë tetë muajve të parë të vitit 1999 ndryshojnë mjaft nga ato të disa viteve të mëparshme. Që nga viti 1993 është hera e parë që në një periudhë tetëmuajore, gjashtë muaj janë me nivele mujore negative inflacioni. Një fenomen i tillë nuk është vërejtur as gjatë vitit 1995, vit kur u arrit norma vjetore më e ulët e inflacionit (në këtë vit vetëm tre muaj ishin me nivele mujore negative). Sidomos në muajt shkurt, mars e gusht nuk janë vërejtur asnjëherë nivele negative. Ndërkohë, duhet theksuar që nuk

⁶ Burimi i të dhënave INSTAT.

⁷ Siç dihet prej kohësh, Shqipëria nuk po arrin të sigurojë një plotësi dhe besueshmëri të informacionit. Kategoritë statistikore të veçanta, me përjashtime të vogla, në pjesën më të madhe janë jo të plota, ndërkohë që sektorë të tërë të ekonomisë prej një periudhe gati dhjetëvjeçare janë tërësisht të pamatur. Kjo gjendje, herëpashere krijon dhe situata të tilla të padëshirueshme kur të dhënat për tregues të veçantë janë në kontradiktë me njëri-tjetrin. Në rastin konkret, megjithë një periudhë pothuaj dyvjeçare rritjeje të lartë në terma reale, treguesi i papunësisë vazhdon të regjistrojë rritje konstante nga njëri tremujor në tjetrin.

⁸ Vlersohen me mijra (burimi: South-East Europe, botim mujor.)

ka ndryshuar mënyra e llogaritjes së këtij treguesi. Pra, edhe gjatë vitit 1999 ndryshimi i çmimeve të konsumit është përcaktuar kryesisht nën ndikimin e grupit “ushqim, pije dhe duhan”.

Nga ana tjetër, lufta në Kosovë nuk çënoi për asnjë moment arritjen e objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë. Indeksi i çmimeve të konsumit ka pësuar rënie të vazhdueshme duke arritur në nivelin 212.8 në fund të gushtit 1999, që do të thotë një ndryshim vjetor në masën -0.6 për qind (vetëm në muajin prill pati një rritje të lehtë çmimesh, si pasojë e rritjes spekulative që pësuan çmimet e ushqimeve). Norma vjetore e inflacionit e arritur në fund të muajit qershor, **tregon se objektivi është arritur**, madje mund të kemi një nivel inflacioni më të ulët se sa objektivi. Duke patur parasysh zhvillimet e disa viteve, vlerësohet së inflacioni mund të arrijë në fund të vitit jo më shumë se 5 për qind.

Faktorët kryesorë që mendohet se kanë ndikuar në uljen e vazhdueshme të inflacionit gjatë tetë muajve të parë të vitit janë:

- ◆ Kërkesa e shtuar për konsum, kryesisht ushqime, u plotësua menjëherë me ndihmat, pra nuk shkaktoi mungesë oferte për këto mallra që të rriteshin çmimet. Këtë e konfirmon më së miri niveli i importeve ndihma për muajin prill, i cili, arrin në 50 për qind të importeve gjithsej, ndërkohë që në vitin kur kanë ardhur më tepër ndihma në Shqipëri (viti 1993) ky raport është 23 për qind. Pra, nuk pati presion për rritje çmimesh në mallra ushqimore. Siç u theksua më lart, spekulimi me çmimet ndodhi vetëm në fillim të muajit prill, kur akoma nuk kishte filluar të funksiononte plotësisht mekanizmi i ndihmave. Kjo bëri që, ndryshe nga muajt e tjerë të vitit, në prill, norma mujore e inflacionit të ishte pozitive (0.01 për qind).
- ◆ Zhvillimet fiskale mbetën brenda objektivave të vendosur. Edhe pse fillimisht u duk se fatura e krizës do të ishte një shumë e madhe për buxhetin e shtetit, donacionet e huaja, sidomos financimet e drejtpërdrejta të buxhetit nga Banka Botërore, bënë që, në njëfarë mënyre, kjo faturë "të paguhej" nga të huajt e për rrjedhim buxheti të lëvizte në drejtimin e programuar. Këtë e demonstroi dhe realizimi i shifrave të gjashtëmujorit. Kështu, në fund të muajit qershor deficiti i përgjithshëm buxhetor regjistron 21.5 miliardë lekë (25.4 miliardë sipas programit) nga të cilat vetëm 9.3 miliardë janë financuar me burime të brendshme (15.2 miliardë sipas programit). Megjithatë, gjykohet që ngurtësia në kryerjen e shpenzimeve buxhetore, sidomos në fushën e shpenzimeve për investime publike, ka dhënë ndikimin e vet në uljen e normës së inflacionit, por, nga ana tjetër, tërheqim vëmendjen mbi koston afatmesme e afatgjatë të kësaj mungese. Në kushtet kur investitorët privatë të huaj dhe vendas nuk tregohen shumë të gatshëm për të investuar, investimet publike duhet të luanin rolin zëvendësues për të krijuar hapësirat e nevojshme për rritje ekonomike në vitet që vijnë dhe zbutjen e papunësisë.
- ◆ Monedha e vendit u paraqit e qëndrueshme, madje me tendencë drejt vlerësimit nga muaji në muaj. Në qoftë se në muajin mars 1999, një dollar

amerikan konvertohej mesatarisht me 142.3 lekë, në muajt korrik e gusht çmimi ra në afërsisht 135.5 e 132.9 lekë, përkatësisht. Të njëjtën rrugë ndoqën dhe monedhat e tjera, ndonëse shkalla e zhvlerësimit të tyre është diçka më e madhe, gjë që reflekton dhe zhvillimet në tregjet e huaja. Gjatë periudhës mars-qershor, fluksit të madh të të ardhurave nga Kosova iu përgjigjën, në të njëjtat përmasa, flukse të shtuara të të hyrave nga jashtë në forma nga më të ndryshme (mall, para). Gjykohet se këto hyrje, jo vetëm ishin të mjaftueshme për të shmangur çdo kosto shtesë për ekonominë shqiptare, përfshirë dhe financat e shtetit, por krijuan një "bollëk" burimesh valutore, i cili çoi në përmirësim të llogarisë korente, nga njëra anë, dhe uljen e presioneve mbi monedhën vendase, nga ana tjetër. Aktualisht, nga Banka Botërore dhe Grupi i të 24-ve është marrë angazhimi për përbalimin e një kostoje fiskale në masën 160 milionë dollarë (30 milionë dollarë u lëvruan deri në muajin qershor 1999) injektimi i të cilave, në ekonomi, çoi në forcimin e mëtejshëm të Lekut. Në kushtet e forcimit të monedhës kombëtare si pasojë e hyrjeve të mëdha merr rëndësi menaxhimi i kujdesshëm i të hyrave valutore nga ana e qeverisë me qëllim që këto fonde "të tepërta" të kanalizohen në projekte për përmirësimin e infrastrukturës dhe investime prodhuese dhe për të dekurajuar kanalizimin e tyre në mallra konsumi, ushqimore, elektroshtëpiake, mallra luksi etj., gjë që çon në rritje të kërkesës agregate duke krijuar premisa për një zbalancim në periudhë afatmesme. Një forcim i mëtejshëm i kursit i të këmbimit (dhe në terma realë është i tillë) do të çonte në rritjen e mëtejshme të importeve dhe nuk do të ishte stimulues për eksportet. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se, një ndalim i menjëhershëm në të hyrat valutore do të çonte në një përmbysje të shpejtë, e për rrjedhim kriza valutore do të ishte e pashmangshme. Prandaj, Banka e Shqipërisë e pa të arsyeshme ndjekjen e një politike që favorizon shtimin e rezervave valutore.

- ◆ U bllokua procesi i privatizimit dhe kredia e sistemit bankar për ekonominë vazhdon të jetë e kontraktuar.
- ◆ Zhvillimet monetare, po kështu, kanë qenë nën kontroll⁹. Duket se kontrolli i vendosur mbi zhvillimet monetare që në vitet e kaluara po vazhdon të ruhet, ndërkohë që politika monetare e Bankës së Shqipërisë është bërë më fleksibile. Gjatë gjithë tremujorit të dytë Banka e Shqipërisë ndoqi me shumë kujdes ecurinë e inflacionit dhe të vlerës së monedhës. Kjo u manifestua edhe në një lloj zbutjeje konstante të politikës monetare ku vlen të përmendet se aktualisht përqindja "bazë" e interesit (përqindja për depozitat me afat në Lekë në bankat tregtare me kapital shtetëror) u ul në nivelin 10 për qind, një rekord historik që nga muaji korrik i vitit 1992. Me këtë ulje interesash, Banka e Shqipërisë synon sigurimin e rritjes së ekonomisë së vendit nëpërmjet uljes së kostos së financimit. Po kështu, vërehet që edhe mekanizmi i transmissioinit të këtyre vendimeve ka filluar të

⁹ Referoju "Deklaratës së politikës monetare të ndjekur në gjashtëmujorin e parë të vitit 1999" për detaje.

vihet në lëvizje. Është shkurtuar periudha e reagimit nga ana e bankave të nivelit të dytë në vijim të vendimeve që merr Banka e Shqipërisë.

*

*

*

Pas gati dy vitesh përpjekje për stabilizim të vendit dhe vendosje të ekuilibrave makroekonomikë, detyrat që shtrohen përpara autoriteteve tashmë janë të një natyre tjetër. Përpjekjet duhet të përqendrohen në konsolidimin e këtyre ekuilibrave dhe në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit.

- Realizimi i këtij objekti fillon me konsensusin e gjerë që duhet të arrihet midis shqiptarëve për të shfrytëzuar momentin historik.
- Liberalizimi i mëtejshëm i ekonomisë së vendit shihet si një tjetër drejtim që siguron integrimin e ekonomisë shqiptare me ekonominë e vendeve të rajonit dhe më gjerë. Liberalizimi ka nevojë të shoqërohet me një proces të tërë legjislativ. Përpjekjet për anëtarësim në OBT dhe Pakti i Stabilitetit përforcojnë domosdoshmërinë e procesit të liberalizimit.
- Shpejtimi i procesit të privatizimit, proces i cili do të reduktonte peshën e ekonomisë joefikase.
- Nisur nga zhvillimet e fundit në rajon, qeveria duhet të përqendrohet në projekte të cilat përfshijnë të gjitha hapësirat shqiptare. Përqendrimi i vëmendjes drejt tregut të ri në Veri të vendit krijon mjaft mundësi për të zhvilluar si sektorin e prodhimit në Shqipëri, sidomos atë të materialeve të ndërtimit, ashtu dhe në sektorin e tregtisë dhe shërbimit.
- Forcimi i disiplinës financiare është një tjetër faktor i rëndësishëm, i cili nuk duhet parë si në kontradiktë me procesin e liberalizimit. Në radhë të parë disiplina financiare do të kërkojë zbatim rigoroz të rregullave të tregut financiar dhe rritje të transparencës së veprimtarisë së tij.
- Si faktor të fundit, por jo më pak të rëndësishëm, do të përmendim zbatimin e këshillave të Grupit "Miqte e Shqipërisë". Nëse në pamje të parë këto këshilla janë për probleme që ne i vetë i kemi identifikuar dhe theksuar si pengesa për zhvillimin e vendit, deklarata e bërë është një kujtesë e vlefshme dhe tregon se tashmë këto probleme duhet të reduktohen.